

PËRPARIMI

Reviste kulturore

MIN. ORO

СИГН.

6394

182

/62

NUMER 7-8

Korrik - Gash 1956

VJETI II

ANTARËT E REDAKSIS:

Ismet Shaqiri, Hivzi Sulejmani, Vojisllav Dançetoviqi, Elhami Nimani, Mehmet Hoxha, Stathi Kostari, Abdullah Zajmi, Mehmedali Hoxha, Lorenç Antoni, Mehdi Bardhi, Xheladin Topçiu, Ali Rexha, Mark Krasniqi, Jusuf Shushka, Hasan Vokshi, Ismet Mula, Shevqet Veliu
Masar Murtezai

KËSHILLI REDAKTUES:

Stathi Kostari, Ali Rexha, Xheladin Topçiu, Hasan Vokshi

DREJTORI PËRGJEGJËS

Elhami Nimani

PËRMBAJTJA:

Dr. IVAN POPOVIĆ:

Elementet latino-romane në gjuhën shqipe

SULEJMAN DRINI:

Kongruenca e gjymtyrëve të fjalís

DUSHAN ANDREJEVIQ:

Ornitofauna e Kosovë-Metohis

TAJAR HATIPI:


Të kuvendojmë sa më shpesh me fëmijt

Dr. VELKO KORAÇ:

Nikolla Teslla — njeri dhe shkenctar

MILLAN RADOVANOVIQ:

Aktivitetet e nxansave jashtë klasës,
por mbrenda shkollës



ELEMENTET LATINO-ROMANE NE GJUHEN SHQIPE

Në agim t'epokës së ré (në kohën e Perandoris) Romakët e shkelën Ballkanin dhe qëndruen aty edhe mbas shkatrrimit të Perandoris romake. Gjatë Mesjetës, në kohën e feudalizmit, bregdeti i Adriatikut, prej Trieshte e deri në Durrës, mbet latin, domethanë roman; kurse në mbrendsin e Ballkanit, rrëth boshtit me randsi strategjiko-ekonomik të cilin e përbâjnë Morava e Vardari, qëndruen Rumunët e soçëm — mbasardhsit e Romakëve. Edhe sod e kësaj dite Rumanija, nji shtet i Ballkanit, e ruen vazhdimin e gjuhës latine në gjuhën e banorëve të saj.

Nji fuqi e ré romake, Venediku, sidomos kah fillimi i kohës së ré, pruni në Ballkan, m'anë tjetër, nji tip të ri të gjuhës romane: gjuhën italishte në formën e saj venedikase.

Popujve të Ballkanit u prunë robnin si Roma, ashtu edhe Venediku; mirëpo ata u sollën atyne edhe qytetnim. Asjni qytetnim tjetër (as ai grek, as turk, as gjerman) nuk patën aq randsi për popujt e Ballkanit sa pat qytetnimi që erdhi me anë t'Adriatikut, prej Rome, së pari latin e mandej italian. Prandej, asnji gjuhë tjetër s'ka aq randsi për gjuhët ballkanike, sa gjuha latine e mandej mbasardhset e saj — gjuhët romane (në radhë të parë italishtja).

Ndikesa e fortë e gjuhës latine përfshiu, në radhë të parë, gjuhën shqipe, meqenëse, në krahasim me Sllavët e Jugut dhe Turqit (e jo me Rumunët e Grekët!), Shqiptarët janë vendosit më të vjetër të Ballkanit. Me fjalë tjera, gjuha shqipe është plot me elemente latine, domethanë, romane prandej albanologjija e vjetër (sidomos G. Meyer) ishte i mendimit me e konsiderue gjuhën shqipe si „gjuhë të përzieme thrako-latine” ose madje si „gjysë-romane”. Kështu, Gustav Meyeri në fjalorin e tij etimologjik të gjuhës shqipe, shkrue në gjermanisht, (Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache) gjeti disa mijë fjalë latino-romane, kurse si fjalë shqipe të vendit ai konstatoi gjithsejt vetëm nga 500. Mirëpo, nji rezultat kësodore nuk është i vërtetë për këto dy arsyena: së pari, sepse prej Meyerit është

spjegue gabimisht nji numër i madh fjalësh. Kët gjâ e vërtetoi mât vonë shkenca. Prá, shum fjalë përnjimend — vendase (*botë, shkoj, nuse*, etj.), ai i shpalli gabimisht si latino-romane. Së dyti, megjithse ndikesa latino-romane në gjuhën shqipe është me të vërtetë shum e madhe, ajo përfshin prap-serap vetëm fjalorin dhe eventualisht *sintaksën* e gjuhës shqipe, por *nuk përfshin kurrsesi sistemin gramatikuer*. Ky është, prá, argument i sigurtë se gjuha shqipe në substancë ka mbetë e pastër prej çdo ndikese së huej. Vërtetë, Meyeri besoi pér ndikesën latine në trajtat e emnave dhe foljeve të gjuhës shqipe, mirëpo Pederseni dhe tjerët treguen se ky besim është mbështetë në spjegim të gabueshëm të shum dukunive. Sod gjith albanologët dijnë se sistemi gramatikuer i gjuhës shqipe është vendas, domethanë „thrakas” e pa elemente të hueja.

Prandej, pra, kur flitet pér ndikesën e gjuhëve të hueja në gjuhën e Shqiptarëvet dhe të stërgjyshëvet të tyne — Thrakasve, gjuha latine zen, me të vërtetë, vendin mât të randësishëm përkah sasija e ndikesave, domethanë në pikëpamje kuantitative, ndërsa, përkundrazi, sa i përket kualitetit, ndikesa latine nuk dallohet me asgjâ prej të tjerave: ndikesës greke, sllave, turke e tjera. Prá, në pikëpamje parimore ndikesa latino-romane nuk dallohet prej ndikesave tjera, por vetëm pse është mât e madhe, mât e gjanë dhe ka zgjatë mât tepër.

Fazën mât të vjetër të kësaj ndikese t’Italís e quejmë latine, e mât të rén romane. Por, ky është ndryshim relativ, sepse s’ka ndërpëmje ndërmjet fazës së parë e së dytës. Në të vërtetë, ajo ndikesë te Shqiptarët ka vazhdue prej ardhjes së Romakëve në Ballkan e deri në têrheqjen e Venedikut prej Ballkanit, e pjesërisht — sa i përket të folunit tosknisht — edhe deri më sod, mbasi në dialektin tosknisht ndikojnë edhe sod Rumunët e jugut — Vllezërit (që ka mjaft sish në Shqipnë e jugut).

Por, megjithatë në shum rasa, e tue u mbështetë në momentet gjuhsore, është e mundun me dallue elementet mât të vjetra („latine”) në gjuhën shqipe prej atyne mât të rejave („romane”). Vetëm dy-tre shembuj. Nëqoftëse gjejmë në gjuhën shqipe ndonji fjalë latine, në të cilën është zhdukë bashkëtingllorja ndërmjet dy zanoreve, atëherë ajo është fjalë e vjetër („latine”, „ballkano-latine”). Shembull klasik pér këtë është fjala *pyll* (prej *pëyll*, kjo prej *pëdhyll*, e kjo mât në fund prej *pëdyll*), e cila është sajue prej fjalës së dialektit latin *padule*. Po kjo vlen edhe pér ndrrimin lat. *br* në shqipe: *r*: farkë prej *fabrica*: domethanë se edhe kjo është fjalë „latine” e gjuhës shqipe. Përkundrazi, nëse gjejmë fjalën *fabrikë* prej së njajtës fjalë *fab(b)rica* (natyrisht, me domethanje tjetër), atë-

herë âsht e qartë se fjala *fabrikë* ka ardhë në kohën mā tē re prej Italianëve (kjo âsht pra, romane” — konkretisht fjalë e huajtun — italishte e jo latine). Nëqoftëse i marrim para-sysh me radhë tē gjitha momentet e këtilla, (e kjo sod âsht nē përparue shum), atëherë do tē mundemi me e ndá tanë vjetra, e dy mā tē reja, si vijon:

A. Ndikesat mā tē vjetra

- 1) Ndikesa ballkano-lindore e dialektit latin (prej tē cilit u zhvillue mā vonë gjuha rumunishte);
- 2) Ndikesa ballkano-perëndimore e dialektit latin (i cili flitej gjatë bregut t'Adriatikut prej Rijekës së soçme e deri nē Durrës)* e quejtun nē shkencë gjuhë dalmatishte. Gjatë Mesjetës dalmatishtja përdorej ende nē Split, nē Dubrovnik (krahasò me shqip *Rush* prej *Ragusa*, me humbjen e bashkëting-lores *g* ndërmjet dy zanorëve!), nē Kotor, n'Ulqin, nē Lesh, nē Durrës, e mandej âsht zhdukë gradualisht.

B. Ndikesat mā tē reja

- 3) Ndikesa italiane (mā së pari dialekti venedikas; mā pak ai i Toskanës, dhe eventualisht edhe dialektet e Italís së jugut, me tē cilën Shqipnija ka pasë lidhje tē ngushta, para ardhjes së Turqve).

- 4) Ndikesa rumune — kjo e fundit s'âsht aq e gjanë.

*

Ndikesat e reja, italiane dhe rumune, mund tē dallohen fare mirë sepse fjalët italishte dhe rumunishte janë relativisht tē reja e ende s'kanë pasë kohë që ta ndrrojnë mā shum fëtyrën formale n'ambientin shqiptar.

Përkundrazi, te shtresa e vjetër „latine”, âsht shum vësh-tirë me dallue tipin ballkano-linduer („pararumun”) prej atij ballkano-perëndimuer („dalmatin”). Sod shkenca konsideron se, simbas gjase, Shqiptarët (domethanë Thrakasit) kanë për-jetue mā së pari ndikesën ballkano-lindore „latine”, domethanë nē kohën kur jetojshin ende nē qendër tē Ballkanit (rreth Nishit, e tjera), tue pasë lidhje tē ngushta me stërgjyshat e Rumunë-ve tē soçëm, tē cilët ende kishin mjaft gjak thrakas¹). Mandej,

* N'Istrí dhe rreth Trieshtës egzistojshin edhe dy dialekta latine, por ato s'kanë ndonji randsí sa i përket gjuhës shqipe.

¹⁾ Për këtë — kam shkrue veçanërisht n'artikullin „Marrëdhjanjet ndërmjet gjuhës shqipe dhe rumune („Përparimi I, Nr. 6, faqe 353-358).

por shum herët, Shqiptarët u shtynë kah Perëndimi, në Shqip-nin e soçme dhe në viset fqinje. Aty ranë nën ndikesën gjuh-sore të „Latinëve” ballkano-perëndimorë gjatë bregut t’Adriatikut, ndikesa e të cilëve vinte prej Durrsit dhe qendrave tjekut, ndërsa bregdetare — atëherë thjesht „latine”. N’at kohë te Shqiptarët hynë ato tjerat — elementet gjuhsore ballkano-perëndimore „latine”.

Si latinizmat ballkano-lindore, ashtu edhe ato ballkano-perëndimore të gjuhës shqipe na do t’i shiqojmë si nji tansí, sepse sikurse thamë, në shum rasa, s’âsht e mundun me bâ dallime. Pra, do ta quejmë tanë shtresën mâ të vjetër thjesht latine (ose ballkano-latine). Por, megjithatë, për shkak plotsimi, do të paraqesim edhe disa rasa, të cilat tregojnë se këto kanë qenë dy dialekta latine të ndryshme. Kështu, bie fjalë ct (domethanë kt) latine zavendsohet me ft në fjalët e marruna prej lindjes (*luftë* prej *lucta*, *taftar* prej *tractarium*) çka na kujton afërsin me rumanishten (rum. *lupta* prej *lucta*), ndërsa për ct latine ballkano-perëndimore në shqipet gjejmë diçka krejt tjetër: jt. P. sh. *trajtoj* prej *tracto* ose *drejt* prej *directus*. Kjo praktikisht do të thotë se fjalët *luftë* e *taftar* Shqiptarët i kanë marrë prej Latinëve n’atdheun e tyne të hershëm, kurse fjalët *drejt* dhe *trajtoj* — n’atdheun e soçëm. Gjithashtu, nëqoftëse *a-ja* latine mbetet a edhe në gjuhën shqipe (për-shembull *gaz* prej *gandum*), atëherë âsht fjalë me origjinë latine ballkano-lindore, e nëqoftëse në vend të *a-s* latine gjejmë e në shqipet (p.sh. *r(r)eze* prej *radia*), atëherë kjo fjalë latine ka ardhë kah Perëndimi i Ballkanit, prej bregdetit. Këto dy shtresa latine në gjuhën shqipe spjegohen me anë të drejtimeve gjeografike të depertimit të Romakëve në Ballkan. Më nji anë, ata, natyrisht pushtuen mâ së pari bregun e Adriatikut (vijën Trieshtë — Durrës), por depertuen edhe në nji rrugë tjetër, ku ishte komunikacioni i përshtatshëm. Kjo ishte rruga e lumejvet në mbrendsin e Ballkanit, që çon prej Austrije (Noricum), prej Viene (Vindobona) nëpër Panoni (Hungarija e soçme) nëpër Budapesht (Aquincum) në Belograd (Singidunum). Me fjalë tjera, ata depertuen në trevën e Ballkanit me anën e Danubit. Mandej, kjo rrugë lumejsh vazhdoi kah jugu me anë të Moravës dhe Vardarit, tue kalue nëpër Nish (Naissus), Shkup (Scupi), e madje edhe nëpër Sofi (Serdica) dhe vende tjera me randsi. Në kët mënyrë kjo valë lindore e kolonizimit romak depertoj në zemër të Ballkanit, prà n’ato vise malore, ku gjindeshin fiset thrakase, që i qëndruen burrnisht çkombtarizimit, dmth. Shqiptarët.

Pushteti i Romës perëndoi dhe Romakët u zhdukën, por, gjurmët e qytetnimit të tyne antik mbetën deri sod në të gjithë

tha gjuhët ballkanike, e në gjuhën shqipe mā tepër se nē çdo gjuhë tjetër.

Të marrim tash e të shiqojmë at shtresë të vjetër, latine, të fjalorit të gjuhës shqipe (si atë lindore, ashtu edhe atë përendimore). Fuqija romake ishte fuqí qytetnuese në Ballkan. Prandej mā së pari do të konstatojmë se Romakët u dhanë Shqiptarëve nji sistem të tanë shprehjesh që ka të bâjë me qytetnimin e kulturën.

Para së gjithash, Romakët ndikuen fuqishëm nē mjetet e prodhimit te stërgjyshat e Shqiptarëve, tue futë nē përdorim format mā të përparueme të jetës ekonomike. Dhe vetë fjala *vepër* (prej lat. *opera*) tregon fare qartë se Latinët i përsosën metodat e punës ekonomike te fiset shqiptare.

Padyshim, ndikesa e Romakëve nē bujqsí âsht e randsishme. Për këtë dëshmojnë fjalët *arë*, mandej *kular* (nē par mendë) dhe emnat e disa kulturave bimore: *mel*; mandej *pemë* (prej *pomum*), pastaj *qepë*, *fier*, *mollë* (prej *melum*), *kësh-tejë*, *ftue* (prej *cotoneum*), *fik*, *pjeshkë* (*shefteli*), *mendër*; *li* (-ni), *kanp* dhe *voji* (prej *oleum*).

Po ashtu e randsishme âsht ndikesa romake edhe nē blegtorin shqiptare, megjithse Shqiptarët janë mësuesat e blegtoris për gjith popujt e Ballkanit. Këto terma blegtorale shqipe kanë origjinë latine: *kafshë*, *kaptinë* („kokë”, gjatë numrimit të kafshëve), *mërzej* dhe *vërrî*, *mërrajë*, e mandej *kal* (gjithashtu rumanisht *cal*, prej *cabalus*), *buell*, *pulisht*, *ftujë*; këtu hyn edhe shoqnuesi i bariut *qeni* (preq *canis*), mandej prodhimet blegtorale *kulloshtër*, *ushûj*, *yndyrë*, *mëshikë*, *shakull*. Nga lamija e shpendtaris kanë origjinë latine termat *pulë* (e njij farefisnije me *pulisht*) dhe *gjel*. Por fjala *pelë* âsht fjalë e vjetër shqipe, megjithse edhe njana edhe tjetra u sajuen prej râjës indoeuropeiske *pel* — që do të thotë „me pjellë” (krah. *pjell*).

Për stërgjyshnit e Shqiptarëve ka randsi të jashtëzakonshme xehtarija romake. Gati e tanë terminologjija xehtare ka origjinë latine (mā vonë këtu ndikuen edhe Turqit; për këtë do të shkruej njiherë tjetër): *shqufur* (*squfur*), *plum(b)*, *rame/rem* (= bakër prej turqishtes), *rrëshinë*, *argjand*, *ar* (prej *aurum*), po edhe: *zgjyrë* e *shpuzë*.

Asht vendimtare edhe ndikesa e arqitekturës latine te Shqiptarët (mā vonë iu shoqnuen, edhe ajo sllave e turke — për të cilën do të shkruej po ashtu me nji rasë tjetër, si e dishmon përsëri nji varg i tanë shprehjesh: *mjeshtër*, mandej *shtëpí/shpi* (? por me shum gjasë!); mbasandej *mur*, *kulm*, *ark* (*hark*), *shkallë*, *tjegëll*, *këlqere*, *plang*, *qepër*, *ashqë*, *trâ(-ni)*, *shul*(?), mandej *shtrat*, *pus*, *kanû(-ni)*, *furrë*, si edhe termat për vendbanimet e katundit e të qytetit: *fshat* dhe *qytet*.

Edhe nji varg objektesh të kulturës materiale kanë emna latinë: *arkë*, *shportë*, *furkë*, *rrotëll*, *sharrë*, *rrashtjell*, *farkë* (prej *fabrica*), *kërqell* (thikë e veçantë me hallkë, prej *circeillus „alka”*), *kûj* (*cuneus*), *mâj*, *mângë*, *sheqe* (kosov. geg. *shellus „alka”*), *që tregon vjetërsi jetike!*), *shkam*, *shalë*, *qelq*, *kum(b)onë*, *eshkë*, *lak*, *fill*, *brekë*, etj. Ndikesën e Romakëve në komunikacion na e tregojnë, jo vetëm fjalët *kal* e *shalë*, por edhe *gerre* (prej lat. *carus*, e kjo prej keltishtes) dhe *rrotë*, si dhe disa fjalë tjera. Mandej mullitarija: *mullî(-ni)* dhe gjelltorja: *fërgoj* (*fërgesë*) si dhe fjalët e përmenduna *furre*, *shpuzë*.

Ndikesën e Romakëve në lamín e jetës financiare e tregojnë numrat *qind „100”* dhe *mij* (tosk. *mijë*) „1000” e gjithashtu edhe folja *kursej* (= *curtiare* me të njajtën domethanje) dhe mbiemni i *shtrejtë* (prej *strinctus „i shtrënguet”*). Por katër âsht fjalë vendase (ka farefisni me *quattuor*, porse nuk âsht sajue prej saj).

Romakët u treguen fiseve shqiptare edhe disa forma të mënyrës së jetesës mâ të kulturueme. U dhanë disa elemente higjiene dhe medicine, për të cilat dëshmojnë shprehjet *qirue* (prej *curare „me u kujdesue”*), *bâjë* (kjo me anë të sllavistes?), *mjek*, *mjekue*; por edhe nji varg sëmundjesh dhe gjytimesh fizike kanë emna latinë: *shurdh*, *gutë*, *shqep* (prej *sellopus*), *shtrembët*, *lingue*, *zgjebë*, e përkundrejt tyne, edhe *shëndet* (*sanitatem*). Gjithashtu stërgjyshnit e Shqiptarëve kanë nxanë prej Romakëve edhe emnat e gjanave të ndryshme luksoze: emnat e përmendun *argjant*, e sidomos *ar*, mandej pemët kualitative (krahasë më sipër), dhe *mën(d)afsh* (prej *metaxa*). Përdorimi i ngjyrave të ndryshme ka qenë veçanërisht mjeshtëri, që Shqiptarët e muerën prej Romakëve: ndërsa dy ngjyrat themelore të natyrës: *zí e bardh* — janë terma të vietra vendase, emnat *kua* (= *cocceus*), *verdh* dhe toskn. *gjelbër* (= geg. *blertë*) kanë origjinë latine.

Por, në lamín e kulturës materiale, ka randsí të veçantë fakti se peshkatarija dhe detarija e Shqiptarëve kanë emna latinë (gjithashtu edhe italianë; për këtë shif më poshtë kët artikull): *peshk*, *rrjetë*, *fishnjë*, *not* (me bâ not), *lundër*; edhe fjala *ngarkue* e ka pasë domethanjen e parë „me imbarkue n'anije” (krahasë ital. *carico „ngarkesë anije”*, frangj. *cargot*). Ky âsht nji ndër argumentat e Weigandit për me vërtetue se Shqiptarët kanë qenë dikur larg detit. Vetëm atëherë kur Romakët („Latinët” e Ballkanit) u mësuan detarín, Shqiptarët i futën në gjuhë këto dhe shprehjet tjera të ngjajshme.

Nji ndikesë e këtillë shum e randsishme në kulturën materiale tregon tashmâ à priori se duhet me pritë edhe ndikesë të fortë të Romakëve në superstrukturën — në kulturën

mendore. E përnjimend, edhe këtu ka mjaft shembuj të ngajshëm.

Organizimi i familjes dhe i shoqnis, megjithse ka qenë shum i zhvilluem te stërgjyshnit e Shqiptarëve edhe para ardhjes së Romakëve, tash ra nën ndikesë të madhe latine. Shum terma kuptimesh të kësaj sfere jetese kanë origjinë latine: *gjind* (*gens*), *prind*, *fëmi* (prej *familia!*), *ungj*, *ndrikull*, *njerk* dhe *njerkë* (prej *noverca*), *mesë* (prej *nepotia*), *kushri*, *kumtër*, *kumbar*(?), *kunat*, *famull*, *krushk*; por konsiderohet se folja *martue* âsht fjalë shqipe e vendit (e njij farefisnije me *maritare*, por jo e huajtun), kurse janë sigurisht vendase fjalët *nuse* e *nip*, të cilat shkolla e vjetër i mirrte me origjinë latine. Këtu, ndër fjalë të huajtuna latine, duhet me përmendë edhe fjalën e randsishme *popull*. Mâ në fund edhe shprehjet *shoq*, *mik* e *anmik* (tosk. *armik*) e *fqi*, gjithashtu kanë origjinë latine.

Për organizim shtetnuer e administratë, Romakët qenë organizatorë të famshëm. Së këndejmi u mbeten Shqiptarëve edhe nga kjo lami e jetës shum shprehje të randsishme prej tyne: *m(b)ret* (= ruman. *impărat*; të dyja prej *imperator*¹), *pushtet* (prej *potestate-m*, prej së cilës âsht dhe italisht *podesṭà*), *urdhën*, *shërbtuer*, *gjyq* dhe *gjykue*, *ligj* e mandej *këshill* (prej *consilium*), *kuvend* (në kët domethanje në Shqipnë e Veriut; por ndoshta âsht fjalë vendase), *harmshur* (prej *admissarius*), *ndreq*, kuptimet juridike të pronsis: *kufi* (tosk. *kufi*), i *vorfën* (prej *orfanus*), *dam* dhe *damtoi*, *detyrë* (prej *debitura*), etj. Edhe marrëdhanja e qytetit me katund âsht latine (*fshat* ndaj *qytet*).

Në lidhje me jetën shtetnore, edhe jeta ushtarake âsht mjaft nën ndikesën e Romakëve, për çka dëshmojnë fjalët *ushteri* (prej *hostis*, „anmik”), *luftë* (prej *lucta*, „betejë”), *paqë*; mandej *pré-ja* (prej *praeda*, që do të thonte „plaçkë”²). Gjithashtu edhe armët e ndryshme: *armë*, *shpatë*, *shëngjetë* (me variante).

Romakët kanë bâ shum për zhvillimin e kulturës te popujt e shtypun, sadoqë duket çudí. Këtë na e argumentojnë disa shprehje shum të randsishme me origjinë latine në gjuhën shqipe: *arsye* (prej *rationem*), *shkrue*, *letër* (letër mund të jetë edhe prej lat. *littera* dhe prej ital. *lettera*), e mandej *përrallë*, *vjershë*, *kangë* dhe *këndo*.

Pak a shum edhe tanë terminologjija shqipe e kishës katolike, ajo mâ e vjetra — âsht me origjinë latine (ndërsa mâ

¹) Por, perëndi âsht fjalë vendase!

²) Edhe gjerman. **Krieg** „luftë” në fillim kishte kuptimin „plaçkë” dhe ka lidhje me foljen **kriegen** „me fitue, marrë, rrëmbye”.

e reja ka ardhë prej italishtes; krahasò mā poshtë): para së gjithash kishë (prej *culesia*, e kjo prej greq. *ekklesia*), kryq, bekoj e mallkoj; meshë, prift (prej *presbyter*), ûngjill, engjell dhe dreq, djall, dhe mëkat (prej *peccatum*), mandej emnat e të kremteve: Kërshëndellë (dhe variantet; prej Cristi natalia), Pashkët, Shajet (prej *Rosalia*), Kreshmet (prej *quaresima*), agjinoj. Nga mitologjija popullore me origjinë latine vlen me përmendë fjalën *zanë* (që s'âsht gjâ tjetër porse perëndesha antike *Diana*; *di(a)* — jep rregullisht za — sikurse edhe te fjala *gaz* prej *gandum*, etj.; krahasò gjithashtu edhe në rumunishte *Zâna* — emni i ndonjij zane), mandej *drangue* (*kulshedër* âsht fjalë shqipe vendase!).

Edhe latinizmat shqipe sa i përket kalendarit dhe emnave të stinëve kanë lidhje me ndikesën latine të kishës kato-like: *pranverë*, *prëndverë* dhe *verë* (ndërsa *vjeshtë*, *britëm* dhe *dimën* janë vendase); *Kallënduer*, *Shkurt* (dhe *Fruer*), *Mars*, *Prill* (porse edhe këtu kemi emna tjerë me origjinë vendase). Poashtu edhe *jetë* (por jo *vjet!*), mandej *herë*, megjithse sod kjo fjalë në gjuhën shqipe ka kuptim ndajfoljuer, ajo âsht sajue prej lat. *hora* („orë”).

Kaq për elementet latine — si terma t'ashtuquejtuna kulturore.

Mirëpo, pjesëmarrja e pushtuesit latin në jetën e Shqiptarëve ka qenë aq e fortë, saqë, natyrisht, nuk âsht kufizue vetëm në jetën thjesht kulturore, por, mund të thuhet, se ka përfshî edhe të gjitha lamít e jetës së përditshme. Në kët mënyrë kemi fakte se — t'i marrim tash këto kuptime — çfa-qjet e ndryshme të jetës shpirtnore quhen përsëri me shrehje latine: *shpirt*, *gaz* dhe *gëzue*, *kujtue*, *Shqip*. e veriut *kuptue*, *mend* dhe *mendue*, *vërtetë*, *pëlqeji*, *dëshroj*, *i lirë* dhe *liri-ja*, *lirue*, *nder* (prej *honorem*), *mall* me kuptimin „*dëshirë e flaktë*”, *fat*, *mëni*, *turbull*, *turp*, *faj*, *tmer* (prej *timorem*), *urrej* (prej *horrere*), *vyej* (tosk. *vëjej*; prej *valere*) etj. Vetëm ndikesa turke në kët lamí ndoshta âsht mā e fortë se ajo latine.

Por, edhe natyra bashkë me qenjet e gjalla — te stërgjyshnit e Shqiptarëve të soçëm kanë marrë gjithashtu shum emna latinë. Natyrisht, kjo s'do të thotë se Shqiptarët kanë nxanë vetëm prej Romakëve se çka âsht natyra (fundi i fundit, këtu ka plot elemente vendase të ruejtuna)¹⁾ porse — me fiset shqiptaro-thrakase kanë qenë të përziem edhe shum kolonista romakë. Qe disa fjalë latine të këtij lloji: *pyll*, *shelq*, *plep* (prej *populus*; rum. *plop*), *qarr* (edhe sërbisht *cer* e shqip *qarr* prej lat. *cerrus*), *bush*, *lar* (prej *laurus*), *tufë*, *gjineshtë*, *larushk* (s'ka lidhje me *lar*, por me *labrusca*), *kënetë*; mandej

¹⁾ Shif për këtë artikullin tem „Elementet vendase në fjalorin e gjuhës shqipe” „Përparimi” II, Nr. 2, faqe 78 e tutje).

lepur, kapruell, bishë (thjesht teorikisht, fjala mund të jetë edhe prej lat. *bestia* edhe prej ital. *biscia*; në të dy rasat del trajta shqipe *bishë*, *breshkë* (rum. *broască*), *iriq* (*uriq*), *gjingallë*, *pëllum(b)*, *qift* (prej *accipiter*; e *shqype?*), *korb*; mandej fund dhe *qiell*, *rânë* (tosk, *rërë*; prej *arena*), *shullâ* (prej *solanum*), *flakë*, *shkum(b)ë*, dhe *terrmét* (*terrmék*; prej *terrae motus*). Porse fjala kodër, edhepse besohet nganjiherë, nuk âsht latine.

Mandej, edhe pjesët e ndryshme të trupit kanë emna latinë (megjithse edhe këtu Shqiptarët kanë shprehje vendase të ruejtuna). Këto fjalë kanë origjinë latine: *qime*, *kafkë*, *fytërë*, *faqe*, *tam(b)la*, *gushë*, *shpatëll*, *shpinë* (ose prej ital.?), *gjymtyrë* (prej *iunctura*), *ijë*, *kam(b)ë*, *kofshë*, *themër*, *shollë*, *shtat*.

Përpos kësaj, edhe disa mbiemna, që shënojnë cilsí të ndryshme, janë latinë: *i fortë*, *i naltë* (rumun. *înalt*), *i shpeshtë*, *i ngushtë*, *i shkurtë*, *i shkretë*, *i vjetër* si dhe folje të ndryshme që shënojnë veprime fizike: *pushoj*, *peshoj*, *fërkoj*, *mrrî(j)*, *luej*, *mërgoj*, *ulurîj*, *kërkuj*, *këm(b)ej*, *kallzoj*, *lëshoj*, *lenoj*, *shëmllej*, *dërgoj*, *shtrëngoj*, e madje *vîj* (*vjen*).¹⁾

Mâ në fund, kanë origjinë latine edhe fjalët *shum* e *pak* (prej *summus* dhe *paucus*), *kundër* dhe *qark*, etj.

Vetëm na mbetet të pyesim: a mos âsht ndoshta edhe emni kombtar *Shqip*, po ashtu me origjinë latine? Sëpse padyshim fjala *shqipue* në të vërtetë rrjedh (prej *excipere*). Simbas kësaj *shqip* në fillim do të thonte „ai që kupton” tue u dallue prej të huejvet, që, në kët perspektivë, do t’ishin, si me thanë, „Jo—*Shqip*”, dmth. „të cilët nuk kuptojnë”. Kjo s’do t’ishte farë çudije, sepse: 1) edhe popujt tjerë kanë shpesh emna të huej: *Rusët* e kanë emnin me origjinë norvegjeze, *Bullgarët* — turke, *Françezët* — gjermane, etj.; 2) edhe ashtu popujt e quejnë vehten „ata që dijnë me folë”, e të huejt „ata që janë memec” (kështu fjala sllav. *Slovene* do të thotë „ata që flasin”, kurse fjala sllav. *Nemci* „ata që janë memecë”). Natyrisht, në kët rasë lidhja e emnit kombtar *Shqiptar* me emnin shqipe — do të jetë fryt i fantazis së popullit e kurrgjâ tjetër.

Në kët mënyrë e shterrëm grupin A), domethanë shtresën e vjetër („ballkano-latine”, si atë lindore ashtu edhe atë perëndimore) latine të gjuhës shqipe.

Tash po kalojmë në grupin B), domethanë në ndikesat mâ të reja, romane. Këto janë ndikesa italiane dhe rumune. Si-

¹⁾ Mirëpo, ndërsa nji palë trajta të këtyne foljeve kanë origjinë latine (*vîj*, *vjen*, etj.) të tjerat janë të vjetra, shqipe vendase (*erdha*). Rasë shum interesante.

kurse përmendëm mā sipër, këto fjalë janë relativisht të reja, mā pak të deformueme dhe njifen mā lehtë. Prandej këtu mundemi — së paku në shum rasa me gjithse ka përjashtime,¹⁾ — me dallue atë që është italiane prej asaj që është rumune.

Po marrim tash mā së pari ndikesën italiane, e cila na kujton menjisherë anijet veneciane, admiralat e të cilave do gjën dhe plaçkitën brigjet e Jugosllavis, Shqipnís e Greqis, por të cilët, gjithashtu, mbajtën gjallë komunikacionin në bregdetin e Dalmacís, Shqipnís dhe Greqis. Asht fakt se fjalët italishte janë mjaft të përhapuna ndër të gjitha gjuhët ballkanike, mā shum te Jugosllavët e Shqiptarët, e mā pak te Grekët e Turqit.

Edhe këtu po marrim mā së pari ndikesën kulturore. Mirëpo, para se të paraqesim, për ilustrim, njifarë materiali, duhet të ndalemi në disa çashtje parimore. Ndërsa ndikesa latine — së paku në rasat mā të shumta — ka qenë e përhapun në të gjitha dialektet shqipe, te ndikesa italiane dallojmë rasa të ndryshme. Përnjimend, ka fjalë italishte që kanë përfshirë si të folunit gegnisht, ashtu edhe tosknisht, e madje gjinden edhe në të folunit e Shqiptarëve të Greqis. Por, ka edhe asosh që kufizohen në viset e veriut të Shqipnís, për arsyet se pushtet i Venedikut vazhdoi edhe atëherë, kur Tosknija ishte në duert e Turqve. Veçanërisht, vlen me theksue ndikesën e fortë të Venedikut dhe të kulturës së tij në Shkodër dhe në Malsin e saj. Asht interesante me konstatue me kët rasë se shpeshherë disa italianizma gjinden në dialektin sërbisht të Malit të Zí si dhe në dialektin shqip të Shkodrës, kurse nuk ka asosh as në Bosne, as në Toskní. Për shembull, fjala sërbisht malazeze *vijač „udhë”* = shqip shkodranisht *viaç* — që të dyja prej ital. *viaggio*; në viset tjera të Jugosllavis dhe të Shqipnís — kjo fjalë nuk njifet.

Por unë këtu nuk mund të hyj mā thellë në kët problem, sepse, fundi i fundit, kjo punë kërkon studim special, e për të — s'është vendi këtu.

Po kalojmë, pra, në vetë materialin e fjalorit dhe po marrim mā së pari jetën ekonomike dhe kulturën materiale.

Bujqsija shqiptare kurrnjerë s'ka râ nën ndonji ndikesë italiane shum të fortë; por prap se rap gjejmë foljen *livroj*, „me punue tokën” (prej *lavorare*) dhe emnin *farë*; mandej nji varg kulturash bimore, kultivimi i të cilave ka ardhë prej ndikesës italiane: *oriz(-zi)*, *artıçok*, *kokomare* (për shembull në Tiranë), *limon* (me variantet), *vishull „vishje”* (prej *visciola*), *mendulle „bajame”*, mandej *tërfojë*, *trifojë*.

¹⁾ P. sh. *fushë*, thjesht teorikisht, mund t'ishte prej ital. *fascia* dhe prej rumun, *fashë* (për arsyet teknike trajtën rumun, po e shënojmë me ortografi shqipe).

Fjalë italishtë gjejmë edhe në shum lamë tjera të kulturës materiale, që meritojnë me u përmendë.

Arqitektura: *trinë*, „gardh”, *portë* (ose drejt prej latinishtes?), *balkue*, *finestrë* (trajta *fjeshtë* është simbas gjases prej latinishtes, sikurse edhe dalmat. — kroat. *ponistra*, *funjestra*), *çeler* (trajta *qiler* është prej turqishtes), *burk*, *kolonë*, mandej *boç*, *kanjell* (dhe variantet), *kanall*. Gjithashtu edhe mobilet: *karrigë*, *tavolinë* (krahasë me *kariga*, *taulin* në Mal të Zi), *drrasë*...

Mjeshtrija e gjelltaris — për të cilën dëshmojnë edhe emnat e përmendun të kulturave bimore — gjithashtu është nën ndikesë shum të fortë t’Italianëvet: *gradele*, *magje* (*mazhe*), mandej *makarona*, *bërsut* (*përsut*), *putarg* (në Shkodër; „ajvar”) etj. Këtu hyn edhe të shërbbyemit në mënyrë kulturore: *pjatë*, *tajer*, *pirû*, *prokë* (*brokë*). Gjithashtu edhe një varg enësh për langje kanë emna italianë: *bocë*, *bocû*, *botile*, *bote*, *got(ë)*, *garaf*, *rzhull* (Shkodër), *shkërdhec*, etj.

Në lidhje me këtë është edhe hoteljerija: *tavernë*, *kamerier*, *llokandë* (shprehja *lokauda* dihet edhe në Mal të Zi), etj.

Kuptohet se kanë emna italisht edhe objektet e ndryshme për nevoja shtëpijake, po edhe për punimet zejtare: *skrinë*, *kasellë*, *kanavetë*, *baul(l)* (edhe në Mal të Zi *bajul*), mandej *kainac* (*kainice*), *limë*, *kacavidë*, *pallancë*, *vidë* (*vidhë*), *shtamp(ë)* (prej ital. *stampa*); prej këndejej edhe fjala sërbishte *stampă*, *shestë*, *zekth*, po edhe *qall*, *maqinë*, *ritrat* (në Mal të Zi *lentrat*; prej italishtes *ritratto*), *fabrikë*, etj.

N’Itali industrija tekstile ka qenë e zhvillueme qysh prej shekujsh. Asht e qartë, pra, se Italianët kanë furnizue Ballkanin, po edhe Shqiptarët, me mallna tekstili: *r(r)obë*, *kapelë*, *kapuç*, *pa(n)talone*, *fashë*, *faculetë* (*farsulatë* e variantet), *sharvetë* (mâ së fundi prej frangj. *serviette*), *façel*, *fanell*, *ras(-zi)*; *çeng* (fjalë pak e përhapun — prej *cinghia*).

Për Shqipnë ka randsi mjaft të madhe detarija italiane. Pjesa mâ e madhe e kësaj ndikese përfshini vetëm Shqipnë e veriut, ose vetëm Shkodrën me rrëthinë; por ka shprehje që janë përhapë mâ larg. Në kët pikëpamje Shqiptarët përkijnë me Dalmatinët dhe Grekët, porse këso shprehjesh detare italiane kanë depertue edhe mâ tutje — deri në Stamboll. Shkenctari gjerman. M. V. Asmer ka konstatuar një varg bukur të madh këso shprehjesh deri edhe në Rusi, në liqenin Kaspik. Te Shqiptarët gjejmë: *marinar*, *mariner* (prej *marinano*; letrarishte ital. *marinaio*; — po kët origjinë ka edhe sërbokroatishtja *mornar*), *vapor* (dhe variantet), *gale*, *barkë* (trajta tosknishtë *varkë* — me anë të Grekëve!) *navil* (Shkodër), *fustë* (nji lloj anije), *prorë* (prej ital. *prora*; sërbokroat. *prova* — është prej gjuhës veneciane), *timon*, *vel* (p. sh. në Shkodër), ar-

bur „direk anije” (sërbokroatisht *jarbol* âsht e njij farefisnije, por rrjedh prej latinishtes), *ku (r) sar* (si dhe sërbokroat. *gusar*). Po ashtu edhe mbarë meteorologjija detare u detyrohet Italianëve: *shirok*, (dhe variantet) „erë e jugut” (sjell shi), *ponent*, punend „erë perëndimore”, *fortunë* „stuhí”, *bonacë* „kohë e qetë në det” (po ashtu edhe në Dalmaci; prej *bonazza*). ¹⁾

Kuptohet se Venedikasit dhe Italianët tjerë tue ardhë në Shkodër, Durrës, Vlonë dhe limane tjera të Shqipnís, përhapën jetën tregtare dhe financiare. Gjuha na e ilustron mā së miri kët gjâ. Fundi i fundit, dihet se bankierët e mëdhej të botës, Anglezët, nxunë mjeshtërin bankare prej Italianëve. Tregtija dhe veprimtarija bankare u krijuen fuqí politike dhe kulturore republikave borgjeze italiane: Venedikut, Firencës, Pizës, Gjenovës, etj. Mirëpo, në Ballkan, natyrisht, merret parasysh mā së pari Venediku me dialektin e tij. Prej italishtes mund të paraqesim këto shprehje që kanë lidhje me kët lami të jetës shoqnore: *monedhë* (fjalë veneciane), *danar*, *dénar* (sërbisht *dinar* vjen prej greqishtes së ré), *dukat*, *frank* (edhe Françezët kanë *franc* prej Italianëve), *tezur*, *hozurë* „kamatë” (italisht *usura*), *kushtoj* (edhe sërb. *koštati*), *pagoj*, *fitoj*, *mostrë* (prej *mostra*; prej këndeje edhe sërb. *mustra* e gjerman. *Muster*), e sidomos *bango*, *bankë* „vend ku ndrrohen të hollat”.

Edhe komunikacioni âsht në lidhje me tregtin. Sa i përket komunikacionit detar, shif mā sipër. Këtu po shtojmë: *karrocë*, *rrugë* (venecianishte e vjetër *ruga*), *viaç* (*viaggio*), e mandej themelatën e randsishme kulturore postën: *postë*, *post-të* (edhe Jugosllavët fjalën *posta* e kanë marrë prej Italianëve), *kartë*, *markë* (sod Italianët e thonë ndryshe: *francobollo*).

Komunikacionet me botën e jashtme, që bâheshin në pjesën mā të madhe me anë t’Italianëve, kanë dhanë shkas që Shqiptarët të quejnë shum popuj t’Europës Perëndimore me emna që kanë trajtë italishte: *Gjermani*, (prej ital. *Germania*, e jo prej gjerman. *Deutschland*), *Francez* (prej ital. *venc. Francez* = *Francesc*, e jo prej frangj. *Français* — shqiptò frâsé), *Inglez*, *Inglitera* (prej ital. *Ingles-e*, *Inghilterra* e jo prej engl. *English*, *England*), *Spanjë* (prej ital. *Spagna*, e jo prej spanjoll. *Espana*), *Zvicër* (prej ital. *Svizzera*) etj. Krahasò edhe *Xhudhi* (prej ital. *Giudeo* — shqyp. *xhudeo*; po ashtu edhe në Mal të Zì *Žudio*, e në Kroaci *Židov*).

Kisha katolike në Shqipni — madje edhe në kohën e Turqis (si edhe në Bosne) — qe vazhdimisht nën mbrojtjen e Italianëve. Tash termologjija italiane iu shoqnue gjansisht ter-

¹⁾ Mirëpo, besohet gabimisht se fjala *borë* ka lidhje me fjalën veneciane *bora* „stuhí”; fjala shqip *borë* âsht vendase, dhe ka lidhje me *dëborë*, etj.

minologjis latine kishtare në gjuhën shqipe: *fé* (prej venec. *fides*), *vikar*, *frat*, *xhezuit*, *sakrestan*, *abaci*, *sakresti*, *mandej*: *ofic* „shërbim”, *mortor* „vorrim”, *funeral*, *procesion*, *festë*, e mbasandej *predikue*, *profesi*, *krezhmue* (*krezmue*), *konsakrue*; *purgatu(e)r* „vend pastrimi” (simbas besimit katolik), pjesët e veshjes së klerikalëve: *sotane*, *mitër*, *tonsur*, etj. Krahaso dhe *kam(p)anar* (por *kum(b)onë* âsht fjalë e huajtun latine).

Priftat në Shqipni kanë qenë pishtarë t'arsimit. Shprehjet kishtare me origjinë italiane *dishepull* dhe *kolexh* — kanë marrë sod domethanje thjesht civile. Këtu, në lamë t'arsimit, po numrojmë edhe fjalën elementare *shkollë*, mandej edhe *libër* — gjithashtu prej Italianëve (edhe sërb. *škola* âsht prej italish-tes). Poashtu edhe *lexue* (prej venec. *lezere* = leggere). Këtu duhet të shtojmë frytet tjera kulturore: *gazetarín*: *gazetë* (prej *gazzeta*; edhe rusisht *gazeta* âsht më në fund me origjinë italiane); muzikën: *muzikë/muzhikë* dhe instrumentet: *trumbetë* (*trombet*, *trubetë*), *violí* (*djholi*), *kërnet* (*chiarinetto*), mandej pikatura: *piturue* dhe kcimi: *valcue* (me v-fillestare të padallume prej *balzare*).

Edhe në ngritjen e higjienës dhe të shërbimit sanitari kanë pasë randsi specialistat italianë: krahaso *doktor*, *doktoreshë* (prej *dottore*; e jo prej lat. *doctor*), e ndoshta edhe Shkodranisht banjë (prej ital. *bagno* ose prej serbishtes *banja*?). Por këtu kemi edhe emna sëmundjesh prej italishtes, p. sh. *kolerë* dhe *ndisk* „*tbc*” (ital. *tisica*).

Edhe jeta ushtarake e Shqiptarëve ka pësue shum a pak ndikesë italiane (megjithse në kët pikëpamje për Shqiptarët kanë më tepër randsi Sllavët e Turqit): *soldat*, *kapitan*; *pinjall*; *bandjerë*, *alfier* (për shembull te Bardhi), *medaje*. Por, duhet, theksue veçanërisht se kah fillimi i kohës së ré Shqiptarët muerën prej Venedikasve armët e zjarmit, për çka na dëshmojnë shprehjet *pish tollë* (dhe variantet) *pishqollë*, *pistole*, etj.), *bume* (prej *bomba*) dhe *lumbarth* (po ashtu edhe në Mal të Zi *lumbarda*, që të dyja prej dialektit ital. *lombarda*, e kjo prej *bombarda*, që do me thanë „armë për hedhje bombash, granatash”). Por fjalën *pushkë* Shqiptarët e kanë marrë prej Sërbëve, e këta prej Gjermanëve (porse për këtë do të flasim nji herë tjetër).

Edhe prej lamine tjera të jetës politiko-shoqnore po përmendim këto shprehje ital.: *notar* dhe *shkrivan*; *racë*, *forcë*, *rregull*; *rrëm(b)ye*, *kastigue*, *trathhue*, *spijû* (nëpërmjet të sërbishtës?), *bandill* (tosk. *bandith*) „i ngathtë” (prej venec. *bandido* „cub”) etj.

Mirëpo, me këtë nuk shterret ndikesa italiane; por ka edhe fjalë shqipe të rendomta e të përditshme që kanë origjinë italiane; pjesën e trupit: *gojë* (*golë*; më parë prej ital.

gola se sa prej lat. *gula*); dukuní fizike te njeriu: fëdigë *vdigë* (prej venec. *fadiga* = *fatica*), *plagë*;jeta psiqike: *gënjye*, *gabue*, *grindem*, *rebel*, *karakter*, *shpjegue*, *stimue*, *shtimue*; (trajta çmue s'âsht e qartë), *konoshtis* (prej *conoscere*, me sufiks *çmue* s'âsht e qartë), *kanet* (ndërsa trajta kënetë, *knet* âsht prej latinishtes; kahasò mât sipër); nga zoologjija — Shqiptarët kanë nxanë prej Italianëve përkafshët egzotike: *papagall*, *kokodril*, *korkodhil* (në trajtë ital. *coccodrilla*), etj.

Mâ në fund vlen me theksue se në gjuhën shqipe ka edhe fjalë thjesht „gramatikore” të marruna prej Italianëve: *segur*, *sigur*, etj., *përorë*, *pror* (prej *per ora*), *ma*, *madje*, *opor* (prej *oppure*); kahasò mât në fund edhe fjalë *copë* (*Tagliavini* ka argumentue se âsht fjalë veneciane); *bandë*, „anë” (tosk.), *fillue* (prej *filare*; *filo* „pê”), *fele* (dial. italisht *fella* prej *ofella*), *parreque* (venc. *parechiar* prej *aparecchiare*), etj.

Kuptohet vetëvetiu se Shqiptarët, të cilët, në kohën e dyndjeve të mëdha prej shtypjes së Turqve, u vendosën n’Italín e jugut, në Siçili e në Korsikë — muerën nji sasi të madhe italianizmash të reja, të cilat nuk gjinden n’atdheun e përparshëm, as në Kosovë—Metohí dhe as në të folunit e Shqiptarëve të Greqis. Poashtu kjo vlen edhe për Gegët e vendosun në Dalmaci, afër Zadrës (katundi Arbanasi — Borgo Eerizzo). Kahasò p. sh. fjalën e Borgo Erizzo *kapošant* „vorreza” prej latinishtes *campo santo*. Fjalën e Kalabris, n’Italín e jugut, bëzonjë „nevojë” (ital. *bisogna*), *amarinjë* „due” (ital. *amare*); në Siçili, p.sh. *nujáment* „mérzi” (prej *annuiamento*) etj. Por, kjo s’âsht aq interesante për linguistikë. Në kët pikëpamje Shqiptarët e Italís janë në situatë të ngjajshme sikurse ishin edhe Kroatët dhe Sllovenët e Istris — gjuha merr fjalë pa asnji rezervë prej gjuhës së kombit sundues në trollin e të cilit jeton. Natyrisht, në Ballkan s’ka ngja kështu, sepse këtu s’ka pasë turma italiane kompakte — por italiane kanë qenë vetëm pushteti dhe shtresat e nalta.

Asht nevojë e domosdoshme që të flasim këtu edhe përfjalët shqipe të librave me origjinë italiane, domethanë për termat e ndryshme kulturore që kanë futë në gjuhën shqipe Shqiptarët e kulturuem, sidomos ata që kanë studiue n’Itali. Sikurse te Turqit e soçëm ku pjesa mât e madhe e termave kulturore, pa marrë parasysh origjinën e largët të tyne, kanë karakteristikë franceze (turq. *üniversite* prej frangj. *université*), e te Serbët zakonisht gjermane (*intenzitet* prej gjerman. *Inten-*

sität), ashtu edhe te Shqiptarët këto europeizma rëndom nuk kanë as tipare franceze, as gjermane, por vetëm italiane. Këtu mendoj për shprehjet si *gjeografi*, *gjeologjí*, etj., të cilat në të vërtetë janë të shumta. Kuptohet vetëvetiu se Italianët kanë qenë si tranzmetuesa të fjalëve të ndryshme europiane në gjuhën shqipe: për shembull *sharvetë* prej frangj. *serviette* me anë t'italishtes; rrobë prej gjerman. *Raub* nëpërmjet t'italishtes, etj. Por, për këto të fundit s'kemi ende studime të nevojshme.

*

Mâ në fund, të mirremi edhe me ndikesën rumune. Nattyrisht, këtu âsht fjala për ndikesën e freskët të gjuhës rumunishte (ndërsa u fol mâ sipër për ndikeshën që kanë bâ stërgjyshnit e Rumunëve). Në krahasim me ndikesën italiane në gjuhën shqipe, ajo rumune nuk âsht e madhe, megjithatë mund të konstatohet. Sidoqoftë, vlen me theksue se rumunizmat në shqipet kufizohen zakonisht në jug, domethanë në Toskní, që do të thotë se kjo ndikesë e ré âsht bâ në trollin e rí e kurrsesi n'atdheun e hershëm shqitaro-rumun në viset qendrore të Ballkanit. Me fjalë tjera, ndikesën e gjuhës rumunishte te Shqiptarët, nuk e kanë bâ Rumunët prej Rumanís së mirëfilltë (t'ashtuquejtunit „Dakorumunë”), por dialekti jugur i Ballkanit, i cili thirret zakonisht *aromun* ose *vllah*. Dihet se Aromunët (Vllehët) banojnë në Shqipní të jugut, Maqedoní, Thesalí dhe Epir, pra në teritorët e Shqipnís, Jugosllavís e Greqís. Sidomos ata të parët që jetojnë në Shqipni, t'ashtuquej-tun Frasheriotë, kanë mundë me ndikue në dialektet shqipe, mât së forti në tosknishte. Kët ndikesë e ndihmoi edhe fakti se këta Rumunë të jugut kanë qenë element mjaft me randsí në pikëpamje ekonomike, sepse janë të njoftun si tregtarë e zejtarë të mëdhej, etj. Megjithatë, ndikesa e tyne në gjuhën shqipe nuk âsht aq e madhe. Analizën e fjalëve rumunishte në gjuhen shqipe ia detyrojmë sidomos albanologut të njoftun gjerman C. Treimerit. Qe disa fjalë rumunishte në shqipet: *mil'ore* „runxë” prej arumunishtes *ml'oară*, pekul „kujdes” prej arum. *picul'u*, *pulkë* „pulë deti” prej *pul'că*. Mâ e përhapuna âsht e vëtmja fjalë *lëvdue* (tosk. *lëvdonj*) prej *lavda(re)*, *laft* „lavdim” prej *alavdu* „lëvdoj”.

Mbetet vetëm edhe problemi i ndikesës së sintaksës romane në sintaksën shqipe. Mirëpo, megjithse âsht shkrue mjaft për këto çashtje në leteratyrën shkencore, prapseprap na sod s'dijmë aq shum për të, por arsyë se âsht mjaft vështirë me konstatue se në çfarë rasash vjen ndikesa prej Romanëve (ballkankë) kah Shqiptarët, e në çfarë rasash anasjelltas. Kështu, për

shembull, disa shkenctarë kujtojnë se nyja (artikulli) në gjyhët e ndryshme të Ballkanit, po edhe në rumunisht, âsht zhvillue nën ndikesën e Thrakasve (stërgjyshave të Shqiptarëve të socëm): krahasë rum. *fratul* prej *frat* sikurse shqip *vëllau* prej *vëlla*, ndërsa, përkundrazi, të tjerët e marrin se në gjuhën shqipe nyja u zhvillue nën ndikesën e sintaksës latine ose romane. Prandej, duhet të kënaqemi këtu me konstatimin se ka plot përputhje ndërmjet sintaksës shqipe dhe asaj ballkano-latine, domethanë, ballkano-romane, por nuk dihet se si ka ardhë ky unjisim.

Në fund po bâjmë edhe një vërejtje. Tue folë për ndikesën latino-romane në gjuhën shqipe, kemi marrë sistematikisht vetëm ndikesat direkte, sepse vetëm ato kanë randsí për historin e kulturës. Kjo s'do të thotë se në gjuhën shqipe nuk ka edhe fjalë prej gjuhëve tjera romane, kryesisht fjalë të reja prej gjuhës frangjishte, (si për shem. fjala *kravatë*, etj.), e diku, diku edhe ndonji fjalë spanjolle (p. sh. *pallavër* prej spanjoll. *palabra*); por të gjitha këto fjalë janë marrë indirekt (me anë t'Italianëve, Jugosllavëve, Grekëve ose Turqve), kështuqë kanë më tepër randsí linguistike se sa të kulturës së përgjithshme. Prandej, nuk e shofim të nevojshme me folë sistematikisht për to.

Dr. Ivan POPOVIĆ